



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:091457

Datë: 01.03.2024

Numri i dokumentit: 05400427

NË EMËR TË POPULLIT

P.nr../..

GJYKATA THEMELORE NË PEJË DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL, me gjyqtarin e vetëm gjykues Mus Povataj, me pjesëmarrjen të bashkëpunëtores profesionale Edona Berisha Kastrati, në çështjen penale ndaj të pandehurit B..M.. për shkak të veprës penale mosveprim sipas dispozitave shëndetësorë gjatë pandemisë nga neni 250 të KPRK-së, i akuzuar nga Prokurorisë Themelore në Pejë Departamenti për Krime të Përgjithshme sipas aktakuzës PP/II nr.991/20 të datës 30.07.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 21.02.2024 në prezencë të Prokurores së Shtetit Ardiana Veseli të pandehurit B..M.., të njëjtën ditë bie dhe shpall publikisht, ndërsa me datë 01.03.2024 përpilon këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri,

B..M.., i lindur me datën në P.., nga i ati J... dhe e ëma Xh.. e vajzërisë D.., me vendbanim në rrugën „Zh.. S..” nr. .. në P.., i pa-martuar i gjendjes së mesme ekonomike, me profesion automatik, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me numër personal, i nacionalitetit Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës dënuar me parë, aktualisht **gjendet në mbajtje të dënimit**.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

Me datë 14.05.2020, rreth orës 20:30, në rr. 'E.. E..' në Pejë, i pandehuri vepron në kundërshtim me vendimin e Ref.n.r.AUV 04/2-337/2020 të dt.30.04.2020 me të Cilin ka qenë i urdhëruar që të qëndrojë në vet izolim dhe të nënshtrohet masës së karantinimit si pasojë e virusit Covid 19, në atë mënyrë që, natën kritike i pandehuri edhe përkundër se ka qenë urdhëruar që të qëndrojë në vet izolim si O rekomandim nga IKSHP-ja, i njëjti nuk ka respektuar vendimin e lartcekur, i cili është marr si masë për qëllim të luftimit dhe parandalimit të përhapjes së virusit në fjalë, por ka dal në qytet së bashku me dëshmitarin T... M.., ku me pas janë ndaluar nga ana e policisë.

-me çka ka kryer veprën penale mosveprim sipas dispozitave shëndetësorë gjatë pandemisë nga neni 250 të KPRK së të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të nenit 7, 17, 38, 39, 43, 69, 70, 71 dhe 250 të KPRK-së, 7, 8 dhe 364 të KPPRK-së, të pandehurit B.. M.. i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

Në shumën prej 200,00 € (dyqind euro), të cilin dënim obligohet i pandehuri ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i pandehuri nuk e paguan dënimin e mbetur me gjobë brenda afatit të caktuar, atëherë dënimi me gjobë do ti zëvendësohet në dënim me burg, ku një ditë burg do ti llogaritet 20 euro.

I pandehuri obligohet që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën prej 40 € (dyzet) euro në afat prej 15 ditësh, pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

Arsyetim.

Prokuroria Themelore në Pejë Departamenti për Krime të Përgjithshme me datën 30.07.2023 ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.991/20 ndaj të akuzuarit B..M.. për shkak të veprës penale veprës penale mosveprim sipas dispozitave shëndetësorë gjatë pandemisë nga neni 250 të KPRK së.

Ne shqyrtimin fillestar të datës 21.02.2024 gjykata në pajtim me nenin 241 par. 1 të KPPRK-se e ka udhëzuar te pandehurin për të drejtën e tij për të mos u deklaruar në çështjen e tij ose të mos përgjigjet në pyetje dhe nëse ai deklaron për çështjen, se nuk ka për detyrë të inkriminojë vetveten ose të afërmin, as të pranojë fajësinë, të mbrohet vetë ose nëpërmjet ndihmës juridike nga mbrojtësi sipas zgjedhjes së tij, të kundërshtojë aktakuzën dhe pranueshmërinë e provave të paraqitura në aktakuzë.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurores gjykata është bindur se i pandehurit e ka kuptuar aktakuzën dhe nuk kanë nevojë për sqarime shtesë. Me pas gjykata e ka njoftuar te pandehurin për pasojat dhe benefitet e pranimit te fajësisë.

I pandehuri është deklaruar fajtor për veprën penale për të cilën është akuzuar duke shtuar se: jam penduar premtoi gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprimet të këtilla, me vjen çka ka ndodh.

Në vlerësimin e pranimit te fajësisë nga ana e te pandehurit gjykata ka kërkuar mendimin nga ana e Prokurorit te Shtetit e cila ka deklaruar se: pajtohem me pranimin e fajësisë nga ana e te pandehurit, i njëjti pranim është bere ne mënyrë vullnetare nga i pandehuri dhe po ashtu gjen mbështetje ne shkresat e lëndës.

Gjyqtari i vetëm gjykues është bindur se ne seancën e shqyrtimit kryesor nuk ekzistojnë rrethana për hedhjen e aktakuzës nga neni 244 i KPPRK-së, si dhe janë vërtetuar faktet nga neni 242 par. 6 të KPPRK-se, ndërsa aktakuza mbështet ne këto prova siç janë: raportit të policit H.. L.. 3950 i datës 14.05.2020, raportit të policit Avni Shatri 9016 i datës 14.05.2020; raportit të policit Hazir A.. B.. #3723-6031 i datës 15.05.2020, me Ref.nr.AUV 04/2-337/2020 te dt.30.04.2020, deklarata e dëshmitarit T... M... e dhënë në stacionin policor në Pejë me datë 14.05.2020; deklarata e të pandehurit B..M.. e dhënë në stacionin policor në Pejë me datë 28.07.2020; si dhe të shikohet foto dokumentacioni dhe shkresat e tjera të lëndës, andaj ka marr aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri duke vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Andaj me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit i cili mbështet në provat në baze te se cilave bazohet aktakuza është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv te aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale nga neni 250 të KPRK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit dhe i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 70 par.1, 2 dhe 3 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurit, gjykata mori pranimin e fajësisë, keq ardhjen e shfaqur nga ana e të pandehurit, ndërsa rrethana rënduese ndaj të pandehurit gjykata ka gjetur se i pandehuri me parë ka qenë i dënuar dhe gjendet ne mbajte të dënimit

Gjyqtari i vetëm gjykues ka vlerësuar se me dënimin e shqiptuar si ne dispozitat te këtij aktgjykimi dhe atë konform nenit 72 par.1 pika 1.7 të KPRK-së mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar ne dispozitën ligjore të nenit 72 par.1 pika 1.7 të KPRK-së gjykata të pandehurit i ka shqiptuar dënim me gjobë meqenëse për veprën penale për të cilën i pandehuri është shpallur fajtor nuk është paraparë masa me e ulët e dënimit.

Duke u bazuar në nenin 449 të KPPRK-së, gjykata i obligoi të akuzuarin që ti paguajnë shpenzimet e procedurës penale dhe atë për paushallit gjyqësor në shumë prej 20,00 € dhe për taksen për programin për kompensimin e viktimave të krimit 20,00 €.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa komfor nenit 369 të KPPRK-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL
2020:091457, 01.03.2024**

Bashkëpunëtorja Profesionale

G j y q t a r i

Edona Berisha Kastrati

Musë Povataj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.